



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

08-129
15.04.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-129 datë 01.04.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-129 datë 12.04.2024, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1898/3 datë 15.04.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 12.04.2024, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.03.2019.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 13-të mbajtur më 02.04.2024, me Konkluzionin ark.nr.02-1715/2 datë 02.04.2024, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-129 datë 01.04.2024 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.03.2019, për shkak se pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1585/1 datë 29.03.2024, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimin të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv Agjencisë.

Në lidhje me këtë, nga ana e Agjencisë me datë 03.04.2024, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-129 datë 03.04.2024, për njoftim se nëse nuk e paguan kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimin të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes, do të miraton vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Megjithatë, më 11.04.2024, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-1585/2 datë



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија**

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

11.04.2024, ku thuhet se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, më 09.04.2024 ka kryer pagesë në shumë prej 2.674.020,00 (dy million e gjashtëqin e shtatëdhjetë e katër mijë e njëzet) denarë, me të cilën kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-129 datë 01.04.2024 dhe Propozimin PA1 nr.08-129 datë 12.04.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1898/3 datë 15.04.2024, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 15-të mbajtur më 12.04.2024, vendosi të ndalon procedurën e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).